



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.1033/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit VM3 Shpk me seli në Rr. Gjergj Balsha nr.211 Prishtinë, NRB 8105243145, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1037/22 të datës 28.04.2023, me datë 06.12.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit VM3 Shpk me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1037/22 i datës 28.04.2023, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1037/22 të datës 28.04.2023, e ka Aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.21/21, të datës 15.01.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Afet Mjeku.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1037/22 të datës 28.04.2023 për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit, VM3 ShPK, me numër unik identifikues 510524315, me seli në rrugën “Gjergj Balsha” nr.221, Prishtinë, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka avokat nga Prishtina, të anulohet aktvendimin me numër KPPP.nr.1037/22 i datës 28.04.2023, lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës dhe rrjedhimisht mbetet në fuqi Urdhri për Përmbarim P.nr.21/2021 i datës 15.01.2021, lëshuar nga Përmbaruesi Privat dhe të Detyrohet Debitori Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, që Kreditorit VM3 ShPK me seli në Prishtinë, t’ia paguaj të gjitha shpenzimet nga procedura përmbarimore dhe shpenzimet e angazhimit të avokatit, sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori VM3 Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me datën 15.01.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me numër 2018-838 e datës 27.12.2018.

Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit VM3 Sh.P.K ka caktuar urdhrin P.nr.21/21 të datës 15.01.2021 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.2018-838 të datës 27.12.2018 në vlerë prej 940.00 me kamatë ligjore prej 8 %, prej ditës kur Debitori ka rënë në vonës për përmbushje të detyrimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1037/22 të datës 28.04.2023 me të cilin e ka Aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës, dhe e ka anuluar Urdhrin përmbartimor P.nr.21/21, të datës 15.01.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhoma e shkallës së parë është referuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 i LPP-së. Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet që e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtës i mungon nënshkrimi apo vula e debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturën mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri, ndërsa ky i fundit të njëjtën e ka pranuar dhe është njoftuar me detyrimin që buron nga fatura.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, kur me aktvendimin e ankimuar, ka Aprovuar prapësimin e kreditorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban vulën dhe nënshkrimin e debitorit, respektivisht nuk dëshmohet pranimi i rregullt i faturës. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet

ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes se detyrimit monetar*”.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, vlerëson se janë tërësisht të paqëndrueshme pretendimet lidhur me rregullsinë e faturës lëndore, për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një faturë të lëshuar nga kreditori, e cila nuk dëshmon se është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se fatura është dorëzuar te debitori, pasi që e njëjta nuk është e protokolluar dhe vulosur nga debitori, dhe si e tillë nuk është dokument i përshtatshëm për përmbardim. Kjo gjykatë nuk mund ti pranoj pretendimet ankimore se fatura e lëshuar nga kreditori është pranuar dhe arkivuar nga debitori, sepse nuk mund të vërtetohet se pranimin-arkivimin e faturës me një plotësim me shkrim, e ka bërë personi i autorizuar i debitorit.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbardimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.1033/23 datë 06.12.2023

Gjyqtari,  
Krenar Berisha